



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1
në Universitetin IMT Mines Alès, Francë**

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike**, (Inxhinieri Mekatronike) në IMT Mines Alès.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Master - Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, (Inxhinieri Mekatronike).

Kohëzgjatja e bursave:

- 1 semestër (shtator 2022 – janar 2023)

Fusha e studimit:

- Mechatronic Engineering

Numri total i studentëve: 5 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit, në shqip dhe në anglisht;
- Listë notash e studimeve Master, deri në momentin e aplikimit, në shqip dhe në anglisht;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

*Niveli minimal i kërkuar i gjuhës angleze është **B2**. (Preferohet niveli C1, IELTS.) Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar, duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merren në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës. Për plotësimin e Learning Agreement ju lutemi kontaktoni me Drejtuesin e Departamentit të Automatikës.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në IMT Mines Alès, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement”, ju lutemi, klikoni te link-u:

[ANEKS 2 - Mobility-agreement-studies, student.pdf \(upt.al\)](#)

Për t’u njohur me programin e lëndëve të Mechatronic Engineering, në IMT Mines Alès, ju lutem klikoni në link-un: [MECATRONIQUE Brochure 2022.pdf \(imt-mines-ales.fr\)](#)

Dorëzimi i dokumentave të nevojshme për aplikim kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT, **brenda datës 30 Mars 2022**.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al dhe rkodra@upt.al.